

# Çfarë është 529 Plan Account?

## 529 Çfarë është 529 Plan Account?

529 Plan Account është një lloj llogari investimi e krijuar posaçërisht për **të ndihmuar familjet të kursejnë për arsimin e lartë**. Paratë në 529 Plan Account mund të rriten me kalimin e kohës. Megjithatë, nuk garantohej që paratë në një 529 Account do të shtohen dhe madje mund të humbin vlerë. *Plani direkt* 529 i Nju Jorkut është plan kursimi për kolegji i administruar nga Zyra e Inspektorit Financiar të Shtetit të Nju Jorkut (Office of the Comptroller of the State of New York) dhe nga Korporata e Shërbimeve të Arsimit të Lartë të Nju Jorkut (New York Higher Education Services Corporation).



## Çfarë është Llogaria e Bursës Shkollore e Qytetit të Nju Jorkut?

Përmes Programit "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program) **çdo nxënës kopshti i regjistruar në shkollat publike të qytetit të Nju Jorkut** (përfshirë shkollat pjesëmarrëse charter) merr automatikisht një **Llogari Burse Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) me \$100 si fillim** në emër të tyre, nëse prindi ose kujdestari i tij "zgjedh të mos marrë pjesë" në Program. Familjet mund të fitojnë deri në **\$175 fonde shtesë burse** për këtë llogari dhe komunitetet mund të kontribuojnë me fonde shtesë në Llogaritë e Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut për të treguar mbështetjen e tyre ndaj suksesit të çdo fëmije.



529

## Çfarë është lidhja mes një Llogarie të Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut dhe një 529 Plan Account?

NYC Kids RISE, një organizatë jofitimprurëse, është zotëruesja dhe menaxhuesja e fondeve të bursave në emër të nxënësve pjesëmarrës dhe i investon ato në NY 529 *Direct Plan*. Llogaritë e bursave shkollore të qytetit të Nju Jorkut mund të fitojnë ose humbasin vlerë me kalimin e kohës, në varësi të tregjeve financiare dhe performancës së investimit. **Fondet e bursës investohen në një 529 Plan në mënyrë që të gjithë nxënësit e shkollave publike të Qytetit të Nju Jorkut të kenë një aset financiar për objektivat e ardhshme në kolegji dhe karrierë**. NYC Kids RISE do t'u ofrojë nxënësve dhe prindërve ose kujdestarëve të tyre informacion mbi mënyrën e përdorimit të Llogarive të Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut kur nxënësit të jenë në shkollë të mesme.

*Programi "Kurse para për kolegjin" i NYC Kids RISE është një program burse dhe kursimesh i administruar nga NYC Kids RISE Inc., një organizatë jofitimprurëse, në bashkëpunim me Departamentin e Arsimit të Qytetit të Nju Jorkut dhe qytetit të Nju Jorkut. NYC Kids RISE nuk është i lidhur me programin "Kurse para për kolegjin" 529 të Nju Jorkut dhe as shpërndarësi i autorizuar i tij dhe nuk kërkon investime ose jep këshilla për investime. Qyteti i Nju Jorkut dhe Departamenti i Arsimit të qytetit të Nju Jorkut (NYC Department of Education) nuk japin ndonjë mbështetje ose rekomandim dhe nuk kanë kontroll, nuk zotërojnë ose janë të lidhur me Menaxherin e Programit 529 të Nju Jorkut (NY 529 Program Manager) dhe as me produkte investimi për kolegji ose investime të caktuara, përfshirë ato që familjet mund të mësojnë përmes programit "Kurse para për kolegjin".*



## Për çfarë investohen paratë në Llogarinë e Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut?

Paratë në Llogarinë e Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut investohen në një portofol që ofrohet nga *Direct Plan* i Programit 529 "Kurse për kolegjin" i Nju Jorkut me **një përzjerje aksionesh, obligacionesh dhe investimesh afatshkurta** (caktimi i asetëve). Në veçanti, NYC Kids RISE ka zgjedhur të investojë Llogaritë e Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut në "Portofolin e regjistrimit të targetit" të NY 529 *Direct Plan*, që është një caktim asetesh investimi bazuar në vitin ku çdo klasë shkollore pjesëmarrëse pritet të regjistrohet në kolegji ose trajnim karriere. Caktimi i asetëve për "Portofolët e regjistrimit të targetit" rregullohet automatikisht çdo tre muaj me kalimin e kohës për t'u bërë më konservator kur Përfituesi (fëmija juaj) i afrohet diplomimit. Llogaritë e bursave shkollore të qytetit të Nju Jorkut mund të fitojnë ose humbasin vlerë me kalimin e kohës, në varësi të tregjeve financiare dhe performancës së investimit. Kur aktivizoni Llogarinë e Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut të fëmijës suaj dhe shfaqni llogarinë e tyre në Gjurmuesin e Kursimeve, mund të shihni që paratë në llogari shtohen dhe pakësohen.



## Për çfarë mund të përdoren paratë në Llogarinë e Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut?

Paratë në Llogarinë e Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut investohen në NY 529 *Direct Plan*. Paratë mund të përdoren për një sërë **shpenzimesh të pranueshme të arsimit të lartë** në institucionet e kualifikuara. Këto institucione përfshijnë kolegjet komunitare, shkollat profesionale dhe teknike, programet e kualifikuara të praktikës së punës si dhe ato virtuale të diplomave, në SHBA dhe jashtë. Shpenzimet e pranueshme përfshijnë pagesën e shkollimit, tarifat, librat, furnizimet dhe pajisjet e kërkuara për regjistrim ose frekuentim në kolegji ose në programin e trajnimit të karrierës, të cilat shpesh nuk mbulohen nga bursat e tjera.



## Çfarë mund të bëj me Llogarinë e Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut të fëmijës tim?

Familjet mund të fitojnë shpërblime shtesë për Llogarinë e Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut të fëmijës së tyre. Tre shpërblimet e para jepen për përbushjen e të ashtuquajturave "3 gurët e themelit" (3 Building Blocks). Këto tre hapa hedhin themelet për një bashkëpunim afatgjatë përmes Programit "Kurse para për kolegjin" për të kursyer bashkërisht për të ardhmen e fëmijës suaj. Përveç shumë fillistare prej 100 dollarësh në llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut të fëmijës suaj, NYC Kids RISE do të ofrojë një shpërblim prej 25 dollarësh për secilin nga këta "Gurë të themelit" të arritur nga familja.

- **Guri 1 i Themelit:** Aktivizoni dhe shikoni online Llogarinë e Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut në [nyckr.org/stregister-529](https://nyckr.org/stregister-529).
- **Guri 2 i Themelit:** Hapni dhe lidhni llogarinë tuaj të kursimeve për kolegjin dhe formimin profesional: zgjidhni nga dy opsione që mund të lidhni llogarinë e bursës të fëmijës suaj. Mësoni më shumë në: [nyckr.org/options-529](https://nyckr.org/options-529).
- **Guri 3 i Themelit:** Depozitoni të paktën 5 dollarë në llogarinë tuaj të lidhur të kursimeve për kolegji dhe karrierë.

Duke filluar nga dita e parë e klasës së parë, familjet që kanë arritur "3 gurët e themelit" do të kualifikohen për **"Të njëjtën shumë të depozituar nga ju"**. NYC Kids RISE do të ofrojë po aq sa depozitoni në llogarinë tuaj të lidhur të kursimeve për kolegji dhe karrierë dollar për dollar, deri në shumën prej 100 dollarësh. Shpërblimet për 3 Gurët e Themelit (\$75 gjithsej) dhe Përputhjen e Kursimeve (\$100) bëhen të vlefshme nga klasa e pestë.



**Kujt duhet t'i drejtohem nëse kam ende pyetje?**

Telefononi NYC Kids RISE në numrin 833-543-7473 ose na dërgoni email në [info@nyckidsrise.org](mailto:info@nyckidsrise.org).

[nyckr.org/faq-529](https://nyckr.org/faq-529)

